



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40. orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky modul, B1, mundëson kryejën e një studimi të përgjithshëm të gramatikës frënge, i cili përfshin emrin, mbiemrin cilësor, mbiemrat e tjerë, përcaktorët e emrit, përemrat, ndajfoljen, parafjalën, lidhëzat. Sitemi foljor do të studiohet në modul më vehte

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs lidhet me studimin sistematik të të gjitha elementeve gramatikore përbërëse të një gjuhe. Ai paraqet një klasifikim dhe shpjegim të elementeve gjuhësore-gramatikore të gjuhës frënge sipas nevojës së përdorimit. Kursi do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të hollësishme të gjitha konceptet themelore dhe strukturat morfologjike të gjuhës frënge, të tilla si procesi i formimit të fjalëve të reja dhe i atyre ekzistuese; pjesët e ligjëratës dhe llojet e ndryshëm morfologjikë të fjalëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre; sistemin emëror dhe foljor etj.

Objektivat specifike lëndore:

Kursi organizohet në 20 seanca leksione dhe 20 seanca seminare. Secila çështje e paraqitur, e analizuar dhe e studiuar në seancën e leksioneve, shoqërohet me cikël ushtrimesh dhe aktivitete praktike në seancën e seminareve. Në këtë modul, do të studiohen rreth 10 çështje gramatikore në aspektin morfologjik.

Për të qenë sa më afër qëllimit për studentët tanë, ky program u përshtatet kërkesave dhe interesave të tyre. Gramatika përbën në vetvete një fushë të gjerë studimi, ku përfshihen studimi i elementeve të fjalisë, sistemi foljor dhe studimi sintaksor.